



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES - VLADA E KOSOVES - GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVA - MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Organizational Org Unit	Nr. Prot. Sing Prot. Protocol
01	05-6116
Nr. i faqeve Br. strana No pages	Data Datum Date
-18-	03/10/2023
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**  
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health  
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr.145/X/2023  
Datë:02.10.2023

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), nenin 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës , nxjerrë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve pas raportit të vlerësimit të infrastrukturës për Klinikat e QKUK-së si në vijim:
  - 1.1. Klinika Gjinekologjike Obstertike
  - 1.2. Klinika e Urologjisë
  - 1.3. Qendra e Emergjencës
  - 1.4. Klinika e Kardiokirurgjisë.
2. Shtojcë e këtij vendimi është Plani i veprimit.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

**Dr. Arben Vitia**  
**Ministër i Shëndetësisë**

**Vendimi i dërgohet:**

- Kabinetit të Ministrit;
- Bordit drejtues të SHSKUK-së;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Drejtorit të SHSKUK-së;
- Departamenti ligjor;
- Arkivit të MSh-së;



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Shëndetësisë - Ministry of Health - Ministarstvo Zdravstva*

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE  
PAS RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË INFRASTRUKTURËS  
NË KLINIKËN GJINEKOLOGJIKE-OBSTETRIKE, KLINIKËN  
E UROLOGJISË, QENDRËN EMERGJENTE DHE KLINIKËN E  
KARDIOKIRURGJISË**

*Prishtinë, 2023*

*Versioni 1.0*

## **Shkurtesat**

BB - Banka Botërore

KTSh - Kujdesi Tretësor Shëndetësor

MSh - Ministria e Shëndetësisë

PV - Plani i Veprimit

QKUK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës

ShSKUK - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

## PËRMBAJTJA

1. Hyrje .....	4
2. Qëllimi.....	4
3. Metodologjia.....	5
4. Sfondi.....	5
5. Monitorimi dhe raportimi.....	9
6. Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i planit të veprimit.....	9

## 1. HYRJA

Inicimi i hartimit të këtij Plani të Veprimit ka ardhur me qëllim të përmirësimit të mirëfilltë të ofrimit të shërbimeve shëndetësore cilësore për pacientët, përmirësimit të kushteve të punës për stafin shëndetësor si dhe sigurimit të hapësirave komode dhe të sigurta për aparaturat moderne. Qendra Klinike Universitare e Kosovës si qendër e vetme tretësore në nivel nacional ofron përgatitje të profesionistëve të ardhshëm shëndetësorë si edhe shërbime shëndetësore. Me qëllim që shërbimet mjekësore të qytetarëve të kryhen në objekte spitalore me infrastrukturë të përshtatshme, duke synuar që në vazhdimësi të arrihen standardet më të larta krahas vendeve të zhvilluara është hartuar ky Plan i Veprimit sipas mundësive buxhetore të operimit. Poashtu krijimi i kushteve më të favorshme, rritja e sigurisë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për pacientët do të ketë ndikim direkt edhe në mirëqënien sociale dhe ekonomike për qytetarët e Republikës së Kosovës. Gjatë analizës në terren janë identifikuar 4 Klinika me kushte të rënduara në QKUK dhe si rrjedhojë e kësaj analize dhe raportit të dal nga ekspertiza ndërkombëtare është inicuar edhe hartimi i këtij Plani të Veprimit. Ky raport është pjesë e Planit të Veprimit në shtojcën 1. Dokumenti përmban pjesën narrative dhe pjesën tabelare ku definohet qartë rezultati me aktivitetet, nën aktivitetet, afatet kohore për zbatim të aktiviteteve dhe nën aktiviteteve në mënyrë të detajuar, kostoja e nevojshme për realizim të tyre, rolet specifike të Institucioneve udhëheqëse dhe mbështetëse si dhe produktet e pritshme pas realizimit të aktiviteteve respektivisht nën aktiviteteve.

## 2. QËLLIMI

Qëllimi i hartimit të Planit të Veprimit lidhur me zbatimin e rekomandimeve konform Raportit të Vlerësimit të Infrastrukturës në Klinikën Gjinekologjike-Obstetrike, Klinikën e Urologjisë, Qendrën Emergjente dhe Klinikën e Kardiokirurgjisë është plan i cili përcakton qëllimet dhe hapat e nevojshëm për përmirësimin dhe zhvillimin e sistemit shëndetësor tretësor – QKUK. Plani ka për qëllim të përcakton strategjitë dhe politikat për zhvillimin e infrastrukturës shëndetësore duke përfshirë investime në hapësirat e brendshme të cilat do të kanë ndikim të drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të punës për stafin shëndetësor, shërbime shëndetësore të qasshme dhe cilësore për pacientët si dhe me rëndësi të veçantë në sigurimin e hapësirave për aparaturat moderne. Ndikimi i drejtpërdrejtë i problemeve infrastrukturore në sistemin shëndetësor ka rëndësi thelbësore në rritjen e nivelit dhe standardeve të cilësisë së ofrimit të shërbimeve. Si rezultat i infrastrukturës aktuale, shumë pacientë kanë përvojë jo të këndshme dhe qasje të mangët në marrjen e kujdesit shëndetësor cilësor si dhe rezultate shëndetësore jo të mira. Përveç kësaj, kjo gjendje ndikon direkt edhe te profesionistët shëndetësor, të cilët përballen me rritje të ngarkesës në punë e që rezulton në cilësi dhe kujdes të mangët të shërbimit shëndetësor për pacientët.

### 3. METODOLOGJIA

Plani i veprimit lidhur me zbatimin e rekomandimeve pas raportit të vlerësimit të infrastrukturës në Klinikën Gjinekologjike-Obstetrike, Klinikën e Urologjisë, Qendrën Emergjente dhe Klinikën e Kardiokirurgjisë është hartuar duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 07/2018 për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit. Dokumenti është hartuar në bazë të rekomandimeve pas analizës dhe përgatitjes së raportit të vlerësimit të infrastrukturës së këtyre katër klinikave. Nga të dhënat e siguruar nga raporti janë identifikuar sfidat brenda këtyre klinikave që kanë ndihmuar që me anë të aktiviteteve dhe nën aktiviteteve të adresohen në këtë PV. Plani i veprimit do të zbatohet për periudhën e ardhshme gjashtë mujore (15.06.2023-31.12.2023), përderisa projeksionet e tjera do të bëhen varësisht nga situata e realizimit të aktiviteteve dhe nën aktiviteteve të caktuara në afate kohore.

### 4. SFONDI

Gjatë analizës në terren janë identifikuar nevojat e klinikave për përmirësim të gjendjes dhe është bërë prioritizimi i defekteve infrastrukturore, respektivisht klinikat që ofrojnë shërbime shëndetësore në kushte jo të favorshme dhe kanë një fluks më të madh të pacientëve në ditë.

**Klinika e Kardiokirurgjisë** - si fushë që merret me intervenimet dhe sëmundjet e zemrës kërkon mjete dhe teknologji të specializuar e posaçërisht hapësira funksionale dhe adekuate për të siguruar efikasitet gjatë kryerjes së procedurave specifike që kryhen në këtë fushë. Infrastruktura jo adekuate në këtë klinikë është një ndër shkaktarët që listat e pritjes për ofrim të shërbimeve janë të gjata. Renovimi i Klinikës së kardiokirurgjisë do të përfshinë:

- **Renovimi dhe riorganizimi i sportelit** – Sikurse në shumicën e klinikave në QKUK edhe në kardiokirurgji sporteli dhe hapësira informuese kanë mangësi. Sporteli paraqet vendin ku pacienti informohet dhe krijon kontaktet e para me stafin. Përshtatshmëria e tyre ka efekt direkt në shërbim më efikas, të shpejt dhe organizim më të mirë të punës.
- **Zgjerimi dhe riorganizimi i dhomave për kujdes intensiv** – Dhomat e kujdesit intensiv duhen të jenë në përputhje me standardet dhe rregulloret ku për momentin kemi mangësi të konsiderueshme në infrastrukturën e kësaj klinike. Mangësi kjo që nuk lejon plotësimin e standardeve organizative. Kjo do të ndikojë në rritje të numrit të shtretërve dhe hapësirave ku pacientët do të qëndrojnë pas intervenimeve kirurgjike.
- **Zgjerimi dhe riorganizimi i dhomave të repartit dhe nyjave sanitare** – gjendja aktuale nuk është e përshtatshme për ofrim cilësor të shërbimeve, andaj renovimi i këtyre dhomave ndihmon në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore. Kjo do të lehtëson dhe ndihmon stafin në organizim të mirëfilltë të procedurave standarde mjekësore.
- **Renovimi i sallave operative** – Sallat operative janë shtylla bazë e Kardiokirurgjisë. Renovimi apo modifikimi i tyre do të rezultojë në rritje të efektivitetit të stafit mjekësorë profesional.

- **Rregullimi i nën kulmit mbi katin e Kardiokirurgjisë** – Zgjerimi dhe rregullimi i nën kulmit do të rrit në masë të madhe hapësirat në kuadër të Kardiokirurgjisë. Kjo do të ndikonte që zhveshtorja e stafit, arkiva, depoja e barnatores, depoja e materialit kirurgjik, dhe depoja e materialit zyrtar të transferohen në këtë pjesë të nën kulmit. Kjo do të ndikojë në mënyrë direkte krijimin e mundësisë së modifikimit të hapësirave në repartin e Kardiokirurgjisë.
- **Rregullimi dhe shtrimi i dyshemes** - Ndjeshmëria dhe intervenimet kirurgjike që realizohen në klinikë kërkojnë kushte që parandalojnë infeksionet, e posaqërisht ato intrahospitalore, prandaj edhe domosodshmëria e rregullimit të dyshemes me material që kanë përmbajtje të tillë paraqet hallkën e parë në arritjen e standardeve botërore.

**Klinika gjinekologjike-obstetrike** - Kjo klinikë me 24,000 m<sup>2</sup> hapësirë vepruese, ka një staf me gjithsej 286 punëtorë në të cilën ofrohen shërbime të natyrës specialistike gjinekologjike mesatarisht në muaj 1000 lindje, mbi 5000 ekzaminime e procedura tjera të nevojshme për qytetarët e Republikës së Kosovës. Infrastruktura jo adekuate në këtë klinikë është një ndër shkaktarët që shumica e pacientëve nuk ndahen të knaqur pas marrjes së shërbimit shëndetësor. Renovimi i Klinikës gjinekologjike-obstetrike do të përfshinë:

- **Renovimi i hyrjes kryesore** – Hapsira e cila paraqet qasjen e parë në mes të pacientit dhe klinikës aktualisht nuk paraqet ndonjë standard . Në këtë klinikë mungon vendkalimi special për karroca, shkallët janë të dëmtuara dhe paraqesin rrezik për lëndim.
- **Renovimet e koridoreve** – koridoret janë hapësira në të cilat pacientët kalojnë shumë kohë, kështu që është esenciale që të janë të përshtatshme dhe të ofrojnë siguri. Në këtë klinikë në krahasim me klinikat tjera koridoret janë mjaft të mëdha, dhe mungesa e ndriqimit të mjaftueshëm dhe prezenca e ngjyrave të errta sjellin ndjesinë e një ambienti të errët dhe të pakëndshëm. Poashtu mungesa e vendeve të pritjes vështirëson edhe më shumë gjendjen e familjarëve që të janë prezent për pacientët në rast nevoje.
- **Renovimi dhe riorganizimi i sporteve** – Sportelet janë vendet ku pacientët marrin të gjitha shërbimet administrative duke përfshirë: identifikimin, regjistrimin, pagesat e shërbimeve shëndetësore etj. Kjo klinikë ka një numër të madh të sporteve, ku 80% e tyre nuk përdoren për shërbime të duhura ose janë jo funksionale.
- **Renovimi i dhomave** – Fokus do të janë dhomat në katin e tretë dhe të katërt. Këto janë dhomat hapësirat ku qëndrojnë lehonat pas lindjeve normale dhe cezariene. Hapësirat ku qëndrojnë lehonat janë të papërshtatshme, jo funksionale dhe nuk ofrojnë privatësi. Në një dhomë aktualisht qëndrojnë më shumë se pesë gra lehona, dhomave ju mungojnë toaletet dhe ato janë të detyruara të ecin në distanca të largëta për të shfrytëzuar toaletet. Pra, mungesa e ambientit të përshtatshëm ka ndikim negativ në komoditetin dhe mirëqenien e pacientëve.

**Klinika e Urologjisë** - kjo klinikë ka 2000m<sup>2</sup> hapësirë vepruese, ka një staf me 53 punëtorë në të cilën ofrohen shërbime të ndryshme. Në muaj mesatarisht ofrohen 81 operacione, 558 vizita ambulatore, 170 shërbime diagnostike dhe procedura tjera. Në këtë klinikë mungon sporteli pra vendi ku duhet të kryhen të gjitha procedurat administrative. Renovimi i Klinikës së Urologjisë dhe bllokut operativ është shumë i rëndësishëm për të krijuar kushte më të mira për pacientët që trajtohen në këtë klinikë. Renovimi i Klinikës së Urologjisë do të përfshinë:

- **Renovimi i korridorit dhe riorganizimi i sportelit** – sportelet janë vendet ku pacientët kryejnë të gjitha procedurat administrative duke përfshirë: identifikimin, regjistrimin, pagesat e shërbimeve shëndetësore etj. Në këtë klinikë sporteli pothuajse mungon fare. Për këtë arsye riorganizimi i sportelit do të ketë efekt pozitiv gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore.
- **Renovimi i dhomave** – në këto 20 vitet e fundit në këtë klinikë nuk ka pasur asnjë investim infrastrukturor dhe dhomat ku qëndrojnë pacientët janë me mangësi të konsiderueshme në infrastrukturë. Renovimet e dhomave do të plotësojnë standarde të rëndësishme të kujdesit dhe sigurisë ndaj pacientëve. Do të krijohen hapësira komode dhe funksionale për nevojat e pacientëve dhe stafit që merret me shërbime shëndetësore.
- **Sallat operative-** Zhvendosja e ESWL (aparatis për thyerje të gurëve) dhe cistoskopisë në lokacionin e bodrumit të Kirurgjisë. Si ESWL dhe Cistoscopia janë në pjesën e bllokut operativ. Më parë është caktuar lokacioni dhe është planifikuar renovimi dhe krijimi i kushteve për këtë veprim. Kjo do të ndihmojë pacientët ambulator të jenë larg bllokut operativ. Me zhvendosjen e tillë të ESWL dhe Cistoskopisë do të krijohet edhe hapsira shtesë për salla tjera operative. Sfidat tjetër mbetet hapësira e vogël e Klinikës së Urologjisë dhe rritja e numrit të shtretërve do të përmironte shërbimet shëndetësore që ofrohen në këtë klinikë. Poashtu me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe zvoglimit të numrit të pacientëve në listën e pritjes është e nevojshme rritja e numrit të sallave të operacionit ( dy më tepër)

**Qendra e Emergjencës** – ka një hapësirë vepruese prej 507m<sup>2</sup> dhe staf me 154 punëtorë ku trajton rreth 250 pacientë në ditë kryesisht në gjendje emergjente. Duke pasqyruar që kjo klinikë as për së afërmi nuk i plotëson kushtet elementare për ofrimin e ndihmës emergjente mjekësore, është shumë e rëndësishme që të përfshihet si njëra ndër klinikat ku do të riorganizohet dhe renovohet infrastruktura e brendshme. Renovimi i Qendrës emergjente do të përfshin:

- **Renovimi dhe riorganizimi i sportelit** – Sporteli në qendrën e emergjencës paraqet vendin ku pacienti kryen kontaktin dhe bisedat e para me personelin shëndetësor. Përshtatshmëria e tyre ka efekt direkt në një shërbim më efikas, të shpejt dhe të organizuar. Nga sporteli pacientët do të drejtohen për në triazh, proces që do të ndihmon në përmirësimin e shërbimit të emergjencave.
- **Krijimi i hapësirave për triazh** – Krijimi i hapësirës së tillë është më se e nevojshme për natyrën dhe dinamikën e punës në qendrën emergjente. Kjo do të ketë efekt direkt në përcaktimin e kohës së pritjes si dhe në identifikimin e nevojave urgjente të pacientëve. Përmes sistemit të vlerësimit të profesionistëve shëndetësor do të përcaktojnë rëndësinë dhe nevojat e pacientëve si dhe identifikimin se cilët pacientë kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme dhe cilët janë ata që mund të presin pak më gjatë.
- **Renovimet e korridoreve** – koridoret kanë ndikim direkt në rritjen e kënaqshmërisë së pacientëve dhe përceptimin që kanë për cilësinë e shërbimeve shëndetësore në qendrën emergjente.
- **Renovimi dhe përmirësimi i hapësirave ku kryhen shërbimet emergjente.** Ky riorganizim ka rëndësi të madhe dhe do të ndihmojë në përmirësimin e efikasitetit të trajtimit të pacientëve. Kushtet do të jenë më të rehatshme dhe më efektive për punën e personelit shëndetësor si dhe do të mundësojë që trajtimi i pacientëve të bëhet në kohë më të shkurtër dhe në kushte më



komode. Gjithashtu qendra emergjente e renovuar do të ndihmojë edhe në përmirësimin e reputacionit dhe në rritje të besimit të pacientëve dhe qytetarëve në përgjithësi.

#### **4.1. Bashkëpunimi ndërinstytucional**

Aspekt i rëndësishëm i realizimit të renovimeve në katër klinikat është bashkëpunimi, komunikimi, koordinimi në mes nivelit qendror pra MSh-së me ShSKUK. Një rëndësi të veçantë ka bashkëpunimi mes drejtorëve të Klinikave që do të renovohen me drejtorët e Klinikave ku do të zhvendosen pacientët si dhe shërbimet të cilat nuk do të mund të ofrohen gjatë kohës së renovimit. Si mekanizëm përgjegjës duhet të caktohen personat përgjegjës për këtë proces në secilën klinikë ndaras.

#### **4.2. Zhvendosja e pacientëve**

Zhvendosja e pacientëve në kohën kur në klinika fillojn renovimet paraqet sfidë dhe kërkon planifikim për mundësitë e krijimit të marrëveshjeve të mundshme në mes klinikave për shfrytëzim të sallave dhe hapësirave me qëllim që të mos ka ngecje në ofrimin e shërbimeve shëndetësore gjatë procesit të renovimit. Shfrytëzimi i hapësirave do të bëhet konform marrëveshjeve paraprake për bashkëpunim. Në klinikën gjinekologjike-obstetrike pacientët do të zhvendosen në reparte brenda kësaj klinike, që do të thotë se pacientët do të zhvendosen në një anë të repartit dhe punimet do të kryhen në anën tjetër. Sa i përket Klinikës së Kardiokirurgjisë bashkëpunimi dhe marrëveshja për zhvendosje të pacientëve do të bëhet me Klinikën e Kirurgjisë maksillofaciale dhe Klinikën e Oftalmologjisë. Gjatë kryerjes së renovimit në Klinikën e urologjisë pacientët do të zhvendosen me marrëveshje me Klinikën e Kirurgjisë Torakale, Klinikën e Kirurgjisë Abdominale apo Kirurgjisë Plastike. Poashtu marrëveshja do të arrihet për shfrytëzimin edhe të sallave të operacionit. Sa i përket Qendrës Emergjente kjo do të bëjë marrëveshje edhe për zhvendosje të pacientëve edhe për zhvendosje të shërbimeve. Kjo marrëveshje do të realizohet me Klinikën Interne me qëllim që ofrimi i shërbimeve shëndetësore të vazhdoj dhe mos të ndërpritet në kohën e renovimit.

## ANALIZA SWOT

<p><b>PËRPARËSITË</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Infrastruktura aktuale e qëndrueshme</li> <li>• Stafi aktual i trajnuar për ofrim të shërbimeve</li> <li>• Aparaturat profesionale dhe të avancuara në secilën klinikë</li> </ul>	<p><b>DOBËSITË</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e kushteve adekuate për trajtimin e pacientëve</li> <li>• Infrastruktura fizike e dobët, e vjetër dhe jo komfor standardeve</li> <li>• Mungesa e privatësisë së pacientëve</li> </ul>
<p><b>MUNDËSITË</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofrimi i shërbimeve kualitative</li> <li>• Krijimi i hapësirave të përshtatshme dhe të mjaftueshme për procedura dhe shërbime mjekësore</li> <li>• Krijimi i ambienteve komode ku do të respektohen të drejtat dhe integriteti i pacientëve</li> <li>• Përmirësimi i infrastrukturës</li> <li>• Përmirësimi i kushteve të punës për stafin</li> <li>• Ngritja e nivelit të besueshmërisë së pacientëve në institucionet shëndetësore publike</li> <li>• Sigurimi i hapësirave për aparaturat diagnostike</li> </ul>	<p><b>RREZIQET</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërprerja e qarkullimit të pacientëve në disa zona të klinikës gjatë renovimit</li> <li>• Zhvendosja e pacientëve në klinikat tjera si dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore emergjente</li> <li>• Pengesat fizike dhe profesionale gjate ofrimit të shërbimeve shëndetësore</li> <li>• Vonesat në përfundimin e projektit si rezultat i kohëzgjatjes së procedurave standarde tenderuese</li> </ul>

### 5. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Institucioni udhëheqës për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit është Ministria e Shëndetësisë. Me qëllim të monitorimit të zbatimit të planit, janë hartuar matricat e monitorimit dhe raportimit për indikatorët e përcaktuar. Korniza e monitorimit përmban rezultatin, aktivitetin, indikatorin, bazën, cakun, mbledhjen e të dhënave si dhe gjendjen aktuale. Matrica e monitorimit është e bashkëngjitur në shtojcën 1.

### 6. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Aktivitetet dhe nën aktivitetet e Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve pas raportit të vlerësimit të infrastrukturës në katër Klinikat në ShSKUK, përkatësisht për Klinikën Gjinekologjike-Obstetrike dhe Klinikën e Urologjisë, do të përkrahen nga Banka Botërore më konkretisht brenda Objektivit Zhvillimor të Projektit (Project Development Objective), projekt ky i cili përfundon me 31.12.23. Ndërsa për Qendrën Emergjente dhe Klinikën e Kardiokirurgjisë do të realizohen sipas zotimit të MSh-së prej fondeve të Qeverisë së RKS, përkatësisht Kodin e projektit 18232 \*Modernizimi i Infrastrukturës së Njesive përbërëse të ShSKUK-së.

# **PLANI I VEPRIMIT**

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PAS RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË INFRASTRUKTURËS NË KLINIKËN GJINEKOLOGJIKE OBSTETRIKE, KLINIKËN E UROLOGJISË, QENDRËN EMERGJENTE DHE KLINIKËN E KARDIOKIRURGJISË**

**REZULTATI 1**

**Infrastruktura e Klinikës Gjinekologjike obstetrike, Klinikës së Urologjisë, Qendrës Emergjente dhe Klinikës së Kardiokirurgjisë e avancuar**

Aktiviteti 1	Afati i zbatimit	Kostoja totale		Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
		Viti 1	Viti 2				
1.1. Renovimi i Klinikës Gjinekologjike Obstetrike	TM4 2023	2,430,720.30 €		BB	MSh	ShSKUK/Kl. Gjinekologjike Obstetrike, BB	Klinika Gjinekologjike Obstetrike e renovuar
<b>Nën aktivitetet</b>							
1.1.1 Renovimi dhe riorganizimi fizik i dhomave (Transferimi i dhomave nga 6-7 shtretër në dhoma me 2 shtretër. Inventar modern për dhomat e pacientëve , duke përfshirë edhe sigurimin e tabelave informuese. Krijimi i banjove moderne në secilën dhomë, banjot do të kompletohen me elemente të sanitaris dhe dush, instalimi elektrik, instalimi makinerik dhe hidroteknik)	TM4 2023			BB	MSh	ShSKUK/Kl.Gjin ekologjike Obstetrike, BB	Krijimi i dhomave moderne për lehonat me ambient të përmirësuar dhe komod.
1.1.2 Renovimi i banjove ekzistuese (Përmirësimi i kushteve të dobëta të banjove ekzistuese , instalimi i elementeve sanitare të reja si tualetet , lavamanët dhe dushet si dhe përmirësimi i dizajnit dhe estetikës)	TM4 2023			BB	MSh	ShSKUK/Kl.Gjin ekologjike Obstetrike, BB	Banjot e renovuara të cilat oforjnë nivel të lartë të higjienës

1.1.3 Renovimi i hyrjes kryesore (Shkallët, dyert, instalimi i rampës për karroca, renovimi i hyrjes së ambulancës specialistike dhe hyrjes anësore, instalimi elektrik dhe makinerik.	TM4 2023			BB	MSh	ShSKUK/Kl.Gjin ekologjike Obstetrike, BB	Hyrja kryesore e renovuar
1.1.4 Renovimi i korridoreve (Pastrimi profesional i dyshemes, përmirësimi i ndriqimit, lysterja, furnizimi dhe sigurimi posterëve/informatave edukative, vendosja e mbrojtseve horizontale nga druri dhe mbrojtseve vertikale metalike	TM4 2023			BB	MSh	ShSKUK/Kl Gjinekologjike Obstetrike, BB	Korridoret e renovuara, ri organizuara, komode dhe të funksionalizuara
1.1.5 Renovimi dhe riorganizimi i sporteleve (Krijimi dhe funksionalizimi i sportelit informues, instalimi i ormanëve dhe kasetave për ruajtjen e materialeve të ndryshme. Furnizimi me kompjuterë dhe materiale tjera të nevojshme administrative. Vendosja e TV dhe rregullimit numëror për pritje të pacientëve. Krijimi i vendqëndrimit për stafin e sigurimit dhe pajisja me kartela speciale për vizitorë, shenjëzimi	TM4 2023			BB	MSh	ShSKUK/Kl Gjinekologjike Obstetrike, BB	Sportelet të renovuara, moderne dhe të funksionalizuara
1.1.6 Renovimi i Ambulancave Specialistike (Renovimi i hapësirës së brendshme, riorganizimi i hapësirës ekzistueses dhe pajisjeve mjekësore, shenjëzimi, instalimi elektrik, instalimi hidroteknik dhe makinerik, krijimi i sportelit dhe hapësirës pritëse për pacientë.	TM4 2023			BB	MSh	ShSKUK, Kl. Gjinekologjike Obstetrike, BB	Ambulancat specialistike të renovuara
<b>Aktiviteti 4</b>	<b>Afati i zbatim it</b>	<b>Kostoja totale</b>		<b>Burim i i financ imit</b>	<b>Inst. udhëh eqës</b>	<b>Inst. mbështetës</b>	<b>Produkti</b>
		<b>Viti 1</b>	<b>Viti 2</b>				
4.1. Renovimi i Klinikës së Urologjisë	TM4 2023	1,243,405.96 €		BB	MSh	ShSKUK/Kl. Urologjisë, BB	Klinika e Urologjisë e renovuar
<b>Nën aktivitetet</b>							

4.1.1 Renovimet e korridoreve (Pastrimi profesional i dyshemes, përmirësimi i ndriqimit, lysterja, furnizimi dhe sigurimi i postereve/informatave edukative, vendosja e mbrojtjeve horizontale nga druri dhe ato vertikale metalike)	TM4 2023			BB	MSh	ShSKUK/Kl. Urologjisë, BB	Korridore të renovuara, reorganizuara, komode dhe të funksionalizuara
4.1.2 Renovimi dhe reorganizimi i sporteleve (Krijimi dhe funksionalizimi i sportelit informues, instalimi i ormanëve dhe kasetave për ruajtjen e materialeve të nevojshme. Furnizimi me kompjuterë dhe materiale tjera të nevojshme administrative. Vendosja e TV dhe rregullimit numëror për pritje të pacientëve. Krijimi i vendqëndrimit për stafin e sigurimit dhe pajisja me kartela speciale për vizitorë, instalimi elektrik dhe makinerik.	TM4 2023			BB	MSh	ShSKUK/Kl. Urologjisë, BB	Sportele të renovuara, moderne dhe të funksionalizuara
4.1.3 Renovimi dhe riorganizimi i dhomave të pacientëve intrahospitalor. (Ndërimi i dyshemes, demolimi dhe zgjerimi i dyerve ekzistuese. Riorganizimi i dhomave me 3 shtretër maximum dhe lavaman. Inventar modern për dhomat të pacientëve, duke përfshirë edhe sigurimin e tabelave informuese. Krijimi i banjove në dhoma të pacientëve, instalimi i sanitarive të reja tualete, lavamanë dhe dush. Instalimi i gazrave medicinale, instalimet elektrike, hidroteknike dhe makinerike	TM4 2023			BB	MSh	ShSKUK/Kl. Urologjisë, BB	Dhoma të renovuara dhe moderne me ambient të përmirësuar dhe komod
4.1.4. Renovimi i bllokut operativ (Ndërimi i dyshemes, demolimi dhe zgjerimi i dyerve ekzistuese, reorganizimi i brendshëm, instalimet elektrike, hidroteknike dhe makinerike, instalimi i gazrave medicinale.	TM4 2023			BB	MSh	ShSKUK/Kl. Urologjisë BB	Blloku operativ i renovuar
<b>Aktiviteti 5</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Kostoja totale</b>		<b>Burimi i financimit</b>	<b>Inst. udhëheqës</b>	<b>Inst. mbështetës</b>	<b>Produkti</b>
		<b>Viti 1</b>	<b>Viti 2</b>				

5.1.Renovimi i Qendrës Emergjente	TM4 2023	779,711.10 €		BK/S hSKU K	MSh	ShSKUK/Qendra Emergjente	Qendra Emergjente e renovuar
<b>Nën aktivitetet</b>							
5.1.1 Renovimi dhe riorganizimi i sportelit (Krijimi dhe funksionalizimi i sportelit informues, instalimi i ormanëve dhe kasetave për ruajtjen e materialeve të nevojshme. Furnizimi me kompjuterë dhe materiale tjera të nevojshme administrative. Vendosja e TV dhe rregullimit numëror për pritje të pacientëve. Krijimi i vendqëndrimit për stafin e sigurimit dhe pajisja me kartela speciale për vizitorë, shenjëzimi, vendosja e kamerave të sigurisë	TM4 2023			BK/S hSKU K	MSh	ShSKUK/Qendra Emergjente	Sportelet të renovuara, moderne dhe të funksionalizuara
5.1.2 Krijimi i hapësirave për triazh, instalimi hidroteknik, makinerik dhe elektrik.	TM4 2023			BK, ShSK UK	MSh	ShSKUK/Qendra Emergjente, BB	Hapësirat për triazh të krijuara
5.1.3 Renovimet e korridoreve (Ndërimi i dyshemesë, demolimi dhe zgjerimi i dyerve ekzistuese, përmirësimi i ndriqimit. Lyerja, furnizimi dhe sigurimi posterëve/informatave edukative, vendosja e mbrojtëseve horizontale nga druri dhe mbrojtëseve vertikale metalike)	TM4 2023			BK, ShSK UK	MSh	ShSKUK/Qendra Emergjente, BB	Korridore të renovuara
5.1.4 Renovimi dhe përmirësimi i hapësirave ku kryhen shërbimet emergjente dhe blloku operativ. Instalimi i gazrave medicinale, intslaimet elektrike, hidroteknike dhe makinerike.	TM4 2023			BK, ShSK UK	MSh	ShSKUK/Qendra Emergjente, BB	Bloku Operativ i renovuar
5.1.5 Renovimi i banjove ekzistuese (Përmirësimi i kushteve të dobëta të banjove ekzistuese , instalimi i elementeve sanitare të reja si tualete , lavaman dhe dush kudo që është e nevojshme dhe gjithashtu përmirësimin e dizajnit dhe estetikës)	TM4 2023			BK, ShSK UK	MSh	ShSKUK/Qendra Emergjente, BB	Banjo të renovuara



5.1.6 Renovimi dhe riorganizimi i bodrumit ( hyrjet, korridorit dhe kthinat e stafit, hollit i pacientëve, shkallët anësore, instalimet elektrike, hidroteknike dhe makinerike).	TM4 2023			BK, ShSK UK	MSh	ShSKUK/Qendra Emergjente, BB	Bodrumi i renovuar dhe riorganizuar
<b>Aktiviteti 6</b>	<b>Afati i zbatim it</b>	<b>Kostoja totale</b>		<b>Burim i i financ imit</b>	<b>Inst. udhëh eqës</b>	<b>Inst. mbështetës</b>	<b>Produkti</b>
		<b>Viti 1</b>	<b>Viti 2</b>				
6.1 Renovimi i Klinikës së Kardiokirurgjisë	TM4 2023	750,976.75 €		BK, ShSK UK	MSh	ShSKUK/Kl. Kardiokirurgjisë, BB	Klinika e Kardiokirurgjisë e renovuar
<b>Nën aktivitetet</b>							
6.1.1 Renovimi dhe riorganizimi i sportelit (Funksionalizimi i sportelit informues, instalimi i ormanëve dhe kasetave për rruajtjen e materialeve të nevojshme. Furnizimi me kompjuterë dhe materiale tjera të nevojshme administrative. Vendosja e TV dhe rregullimi numëror për pritje të pacientëve. Krijimi i vendqëndrimit për stafin e sigurimit dhe pajisja me kartela speciale për vizitorë, shenjzimi)	TM4 2023			BK, ShSK UK	MSh	ShSKUK/Kl. Kardiokirurgjisë, BB	Sporteli i renovuar
6.1.2 Zgjerimi dhe riorganizimi i dhomave për kujdes intensiv (Zgjerimi dhe instalimi i dyerve lëvizëse me qëllim të krijimit të vizualitetit, monitorimi qendror, instalimi elektrik, hidroteknik dhe makinerik, instalimi/riparimi i sistemit të gazrave medicinale)	TM4 2023			BK, ShSK UK	MSh	ShSKUK/Kl. Kardiokirurgjisë, BB	Dhoma të kujdesit intensiv të renovuara
6.1.3 Zgjerimi dhe riorganizimi i dhomave të repartit dhe njave sanitare (Zgjerimi i dyerve dhe instalimi i dyerve lëvizëse, ndërrimi i dyshemesë, pajisja me inventarë për komoditet të pacientëve, instalimi hidroteknik, makinerik dhe elektrik, instalimi/riparimi i sistemit të gazrave medicinale)	TM4 2023			BK, ShSK UK	MSh	ShSKUK/Kl. Kardiokirurgjisë, BB	Dhoma të renovuara

6.1.4 Renovimi i sallave operative (Dyshemeja, lysterjet e mureve, instalimi i ormanëve, instalimi elektrik, hidroteknik dhe makinerik, ndërrimi i derve)	TM4 2023			BK, ShSK UK	MSh	ShSKUK/KI. Kardiokirurgjisë, BB	Sallat Operative të renovuara
6.1.5 Renovimi i pjesës së nën kulmit (Krijimi i depove për material administrativ dhe profesional, krijimi i zhveshtoreve / hapësirave për staf)	TM4 2023			BK, ShSK UK	MSh	ShSKUK/KI. Kardiokirurgjisë, BB	Funksionalizimi dhe renovimi i nën kulmit.